



31-01-2018

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Pristina

149-2018

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (f) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 31.01.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.BASHKIM BEHA** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje -LVV" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Yll Rugova**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Bashkim Beha**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 00.01.2018, nr.100/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Yll Rugova, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të emërimit në pozitën e Drejtorit të kulturës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Bashkim Beha, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 31.01.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka